



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.1 Regj.Them.
Datë Rregj. 17.02.2022

Nr. 1 VENDIMI
Datë 23.02.2022

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: **Gentian MEDJA** (*Relator*)
Gjyqtar: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)
Gjyqtar: **Blerona HASA** (*Anëtare*)
Gjyqtar: **Esmeralda XHILI** (*Anëtare*)
Gjyqtar: **Sokol IBI** (*Anëtar*)

me sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj, sot më datë 23.02.2022, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.1 Akti, datë 17.02.2022 që i përket:

PADITËS: **Subjekti Zgjedhor Lëvizja e Re (LRE)**, përfaqësuar nga Z. Arian Galdini.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr.1150 Prot., datë 23.02.2022 nga Z. Erdal Mema.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimi i vendimit nr.08, datë 15.02.2022 “Për Shqyrtimin e Kërkesës Ankimore Nr. 03, të paraqitur në KQZ në datë 12.02.2022” të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve më anë të së cilës është vendosur: *Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”. Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për*

kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim. Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti “Lëvizja e Re” të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhëve, sipas pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

2. Shqyrtimin e çështjes në themel dhe ndryshimin e vendimit nr.72, datë 12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur: Regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE:

Nenet 45, 48 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nenet 145 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të gjykimit, pala paditëse, Lëvizja e Re, kërkoi:

- Pranimin e padisë sipas objektit.
- Kundërshtimin e vendimit nr.08, datë 15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.3, datë 12.02.2022 të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022 të KSHZ dhe regjistrimin e kandidatit të Lëvizjes së Re për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkinë Durrës, që do të zhvillohen në datë 6 Mars 2022.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kërkoi:

- Rrëzimin e padisë të ngritur nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re.
- Lënien në fuqi të Vendimit nr.8, date 15.02.2022 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanskioneve (KAS).

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore

VËREN

1. Se, më datë 17.02.2022, pala paditëse Subjekti Zgjedhor Lëvizja e Re i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesë-padi duke kërkuar kundërshtimin e vendimit nr.8, datë 15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 3, datë 12.02.2022 të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re, ndryshimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022 të Komisionit Shtetëror Zgjedhor duke vendosur regjistrimin e kandidatit për Kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.

3. Sa më sipër, pala paditëse Lëvizja e Re (LRE) me shkresën me lëndë “Autorizim” nr. 231 prot, datë 26.01.2022 i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku vë në dijeni se shtetasit Kristina Nano, Jonid Nano e Arsen Lazri, autorizohen nga kjo lëvizje politike të përfaqësojnë LRE-në pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të dorëzojnë e të tërheqin çdo dokumentacion të nevojshëm deri në daljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 06.03.2022.

4. Me vendimin nr. 35, datë 02.02.2022 “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë Lëvizja e Re për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 MARS 2022”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi: “1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, “Lëvizja e Re”, me Kryetar z. Arian Galdini me shkronjat nistore “LRE”. Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 2, datë 22.1.2022, Partia “Lëvizja e Re” ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Jonid Robert Nano, si kandidat për kryetar në bashkinë Durrës dhe dokumentacionin shoqërues.

5. Në datën 08.02.2022, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re (LRE) ka bërë dorëzimin e dokumentacionit për kandidatin për kryetar bashkie në qytetin e Durrësit për zgjedhjet e pjesshme të datës 06 Mars 2022 të z. Jonid Robert Nano administruar nga KQZ, me Procesverbalin e dorëzimit të dokumentave të Kandidimit me nr.573 prot, model - 08.

6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi verifikoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” dhe konstatoi se dokumentacioni i depozituar përmban të gjithë elementët dokumentarë, por ka pasaktësi në përmbajtjen e tyre, pasi subjekti zgjedhor nuk disponon mandat në këshillin e bashkisë, Durrës. Vetëdeklarimi i zj. Alneida Nexhmi Rroshi, anëtare e këshillit të bashkisë Durrës, se mbështet kandidatin e subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk përmbush kushtin ligjor sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën “Kërkesë për plotësim dokumentacioni” nr. 788 prot, datë 11.02.2022 i është drejtuar Këshillit të Bashkisë Durrës, vërtetimin për përkatësinë e partisë politike të znj. Alneida Rroshi.

8. Këshilli i Bashkisë Durrës, nëpërmjet shkresës nr. 1372/1 prot., datë 11.2.2022, protokolluar me nr. 788/1 prot., datë 12.2.2022, vërteton se zj. Alneida Nexhmi Rroshi, është anëtare në këshillin bashkiak Durrës, dhe i përket subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

9. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 72, datë 12.02.2022 “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, Z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka vendosur: “Mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022...”, me arsyetimin se, dokumentacioni i depozituar nga

subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, z. Jonid Rober Nano, nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar se nëpërmjet shkresës nr. 1372/1 prot., datë 11.2.2022, këshilli i bashkisë Durrës, vërteton se zj. Alneida Nexhmi Rroshi, është anëtare e këshillit bashkiak Durrës dhe i përket subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” nuk disponon mandat në këshillin bashkiak, Durrës. Vetëdeklarimi i zj. Alneida Nexhmi Rroshi, anëtare e këshillit bashkiak Durrës, se mbështet kandidatin e subjektit “Lëvizja e Re”, nuk përmbush kushtin ligjor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor. Sa më sipër, konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, z. Jonid Rober Nano, nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor.

10. Në datë 12.02.2022 pala paditëse Lëvizja e Re i është drejtuar KAS me Kërkesën Ankimore me nr.03 prot, datë 12.02.2022 me anë të së cilës ka kërkuar “Shfuqizimin e vendimit nr.72 datë 12.02.2022 dhe pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin si kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Durrës të z. Jonid Robert Nano, për shkak të mos zbatimit të afateve procedurale të përcaktuara nga Vendimi nr.02 prot, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

11. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar se pika 3, e nenit 68, të Kodit Zgjedhor vendos kushte forme dhe përmbajtjeje, me qëllim që vërtetimi për zotërimin e mandatit të jetë i vlefshëm dhe i pranueshëm. Vetëdeklarimi i përmendur në këtë pikë është një deklaratë përkatësie politike, e cila nënkupton një marrëdhënie zyrtare, publike dhe të qendrueshme midis mandatmbajtësit dhe subjektit politik, të cilit i përket ai. Kjo marrëdhënie përkatësie nuk vendoset me qëllimin për të shmangur kushtin e nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve në momentin e regjistrimit të kandidatëve. Ajo është marrëdhënie përkatësie që ekziston përtej dhe pavarësisht procesit zgjedhor. Për këtë arsye, ajo ka forcën që të zëvendësojë listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve si kusht për regjistrimin e kandidatëve.

Deklarimi i përkatësisë nga ana e mandatmbajtësit bëhet përpara institucionit dhe jo përpara administratës zgjedhore sepse marrëdhënia e tij e përkatësisë vlen jo vetëm për zgjedhjet, por vlen për çdo marrëdhënie juridike që bazohen në kriterin/kushtin e përkatësisë. Deklarimi I përkatësisë është akt që lidh mandatmbajtësin me subjektin politik dhe jo akt që lidh mandatmbajtësin me kandidatin. Kodi Zgjedhor kërkon me pikën 3, të nenit 68 shpalljen e përkatësisë ndaj subjektit dhe jo, sikurse pretendon ankuesi, shpalljen e mbështetjes për kandidatin.

Znj. Alneida Rroshi është anëtare e Këshillit Bashkiak Durrës, nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Pavarësisht se deklaron mbështetjen për kandidatin e LRE, anëtarja e Këshillit Bashkiak Durrës nuk është vetë në marrëdhënie përkatësie me LRE. Mandati i saj përfaqësues nuk i përket LRE, por i përket PSSH, për pasojë ai nuk mund të zëvendësojë ligjërisht nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve për llogari të LRE, por vetëm për llogari të PSSH.

Lidhur me pretendimin për standart të dyfishtë, KAS ka vlerësuar se rregjistrimi I dy kandidatëve është bërë nga dy organe të ndryshme dhe se nuk është ushtruar e drejta e ankimit për të dy vendimet. Dy vendime të ndryshme për kazuse të ngjashme nuk krijojnë standart të dyfishtë, kur merren nga dy organe të ndryshme kompetente, sa kohë që nuk i nënshtrohen që të dy rrugës ligjore të ankimit.

Për ti dhënë palës kërkuese, të drejtën për të plotësuar dokumentacionin, sipas vendimit nr.2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, KAS ka vlerësuar se i duhet dhënë ankuesit një mundësi, sipas të cilës për një afat 24 orë nga shpallja e vendimit të plotësojë dokumentacionin e kërkuar.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.8, datë 15.02.2022 “Vendim për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, të paraqitur në KQZ në datën 12.02.2022”, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka vendosur: *“1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim. 3. Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti “Lëvizja e Re” të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03, paraqitur në KQZ në datën 12.02.2022” 7 Data: 15 Shkurt 2022, Nr. 08, Ora 12:00, Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhëve, sipas pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor. 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”.*

12. Pas kalimit të afatit prej 24 orë, të përcaktuar me vendimin nr.8, datë 15.02.2022 të KAS, për plotësim të dokumentacionit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi ka rishqyrtuar çështjen, ka vlerësuar se në përfundim të afatit për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, konstaton se subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk depozitoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vërtetimin për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas përcaktimeve të pikës, 3 të nenit 68, të Kodit Zgjedhor ose listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor. Mbi këtë bazë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.79, datë 16.02.2022, ka vendosur: Mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

13. Me datë 17.02.2022, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

PRETENDIMET E PALËVE NË PROCES

14. Pala paditëse, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re parashtroi se vendimi i KAS është marrë në kundërshtim me ligjin procedural dhe ligjin material, për këto arsye:

i. Duke qënë se mandati i këshillit bashkiak përfundon në vitin 2023 nuk jemi në kushtet e pikës 3 të nenit 68 të Kodit Zgjedhor. Nëse do të ishin dekretuar zgjedhjet edhe për këshillat bashkiak atëherë do të duhej që znj. Alneida Rroshi të ishte vetëdeklaruar pranë njësisë së qeverisjes vendore se cilës përkatësi politike i takon mandati i saj. Në këto zgjedhje të dekretuara nga Presidenti i Republikës në mënyrë të papritur, të cilat po zhvillohen me kohë dhe me afate të reduktuara kjo dispozitë e Kodit Zgjedhor do të duhet të lexohej se “këshilltari mbështetës duhet ta zotërojë këtë mandat të paktën për 6 muajt e fundit”, sikurse kërkohet dhe interpretohet edhe nga vetë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në Udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të KSHZ sipas pikës “d”, të nenit 4, ku përcaktohet se subjektet duhet të paraqesin “Vërtetimin e nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e vetëqeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit, të paktën 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose organit të njësisë së vetëqeverisjes vendore;”. Për sa më sipër, dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, Deklaratës të datës 02.02.2022 të firmosur nga këshilltari dhe Vërtetimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.1043 prot, datë 02.02.2022, për regjistrim të kandidatit tregon se kandidati i Lëvizja e Re mbështetet nga një këshilltar në këshillin bashkiak Durrës, i cili e zotëron mandatin e këshilltarit të paktën 6 muajt e fundit.

ii. Koha prej 24 orësh për plotësim të dokumentacionit duke nënkuptuar edhe 1% të firmave mbështetëse të zgjedhësve të Bashkisë Durrës do të ishte në shkelje të nenit 27 pika 3 dhe 4 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, i cili parashikon se: “3. Të dhënat e regjistruara nuk përdoren për qëllime të ndryshme, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. 4. Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.”. Në kuptim të këtyre dispozitave subjekti zgjedhor ka detyrimin që këto të dhëna personale që ka grumbulluar ti shkatërrojë pasi regjistrimi i kandidatit u bë nëpërmjet deklarimit të këshilltarit të Bashkisë Durrës për mbështetje të tij. Duke pasur njohuri për detyrimet që parasheh ligji për mbrojtjen e të dhënave personale subjekti “Lëvizja e Re” ka bërë shkatërrimin e këtyre të dhënave pas kalimit të afatit të paraparë nga Vendimi nr. 02 të datës 22.01.2022 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte pas kalimit të një afati prej 7 ditësh “LRE” e ka të pamundur të recuperojë të dhënat e grumbulluara dhe ti depozitojë ato brenda 24 orëve, afat ky i dhënë nga Vendimi nr.08 i datës 15.02.2022 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) pranë KQZ.

iii. Regjistrimi i kandidatëve për kryetar bashkie të propozuar nga subjekti Zgjedhor “Lëvizja e Re” është gjykuar nga organet e KQZ me standard të dyfishtë pasi e njëjta KQZ që ka gjykuar dosjen e kandidatit për kryetar për Bashkinë Durrës ka gjykuar edhe dosjen e kandidatit për kryetar për Bashkinë Dibër duke dalë me dy vendime të ndryshme. Në vendimin nr.50 të datës 10.02.2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrim të kandidatit të Lëvizjes së Re për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Dibër, z. Dritan Hajri Torba duke urdhëruar KZAZ nr.19 Dibër të bëjë regjistrimin e kandidatit të LRE për zgjedhjet e pjesshme të datës 6

Mars 2022. Në bazë të këtij vendimi, pra, Vendimi nr.50 datë 10.02.2022, KZAZ nr.19 Dibër më datë 11.02.2022 ka marrë vendimin me nr.6 për regjistrimin e kandidatit të Lëvizjes së Re - LRE z. Dritan Torba. Në dosjen e kërkesës për regjistrim të kandidatit të LRE në Dibër gjendet i njëjti dokumentacion sikurse edhe në dosjen e kandidatit të LRE për bashkinë Durrës, kjo na bënë të mendojmë se KQZ po përdor standard të dyfishtë në regjistrimin e kandidatëve të subjektit Zgjedhor “Lëvizja e Re”.

Arsyetimi se kandidatura e Dibrës nuk është ankimuar, ndërsa kandidatura e Durrësit është ankimuar nuk përbën arsyetim ligjor pasi një subjekt zgjedhor tjetër mund të mos dojë asnjë kundërshtar përballë por kjo nuk do të thotë që organi të cilit i është besuar mbarëvajtja dhe garantimi i zgjedhjeve duhet ta dëgjojë dhe ta mbështesë.

iv. Komisioni Rregullator në mbledhjen e datë 22.02.2022 ka marrë vendimin me nr.2 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, në pikën 10 të së cilit përcaktohen edhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit, sipas të cilit përcakohet se: *“Dokumentet e kandidimit paraqiten në KOZ për bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje, si dhe në KZAZ për bashkitë Vorë, Dibër dhe Rrogozhinë, nga data 6 deri në datën 9 Shkurt 2022. KOZ/ KZAZ bën verifikimin e tyre jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja dhe në rast se vëren parregullsi, i kthen për plotësim. Dokumentet e plotësuara duhet të riparohet jo më vonë se 24 orë (njëzet e katër). KQZ-ja/ KZAZ-ja merr vendim jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga riparohetja e tyre.”*

Në zbatim të këtij vendimi subjekti zgjedhor Lëvizja e Re - LRE ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e kandidatit të saj për zgjedhjet e pjesshme për Bashkinë Durrës më datë 08.02.2022 në orën 12:20 (24 orë para përfundimit të afateve zyrtare) e vërtetuar kjo nga Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit Model -08 me nr.573 prot.

Subjekti zgjedhor Lëvizja e Re gjatë 24 orëve pasuese nuk ka marrë asnjë komunikim nga administrata e KQZ për ndonjë mangësi apo parregullsi në dokumentacionin e dorëzuar, çka nënkupton se çdo dokument i dorëzuar është sipas dispozitave të parashikuara në Kodit Zgjedhor të RSh si dhe nenit 6 të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitim dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim, duke konsideruar se vendimi nr.72 i datës 12.02.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimi nr.08, datë 15.02.2022 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) janë të paligjshëm, me anë të së cilëve i është cënuar kandidatit për kryetar bashkie në qytetin e Durrësit, e drejta për t’u zgjedhur e drejtë kjo e garantuar nga neni 45 i Kushtetutës së RSH dhe neni 3 pika 3 e Kodit Zgjedhor të RSh, pala paaditëse kërkon shfuqizim të vendimit nr. 08, datë 15.02.2022 të KAS dhe dhënien e vendimit për regjistrimin e kandidatit të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme për bashkinë Durrës që do të zhvillohen më datë 06 Mars 2022.

15. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pretendoi se vendimi Nr.8, datë 15.02.2022 i KAS është i bazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Pala e paditur

pretendoj se i përmbahet arsytetimeve të bëra nga Komisioni i Ankimeve Sanksioneve në vendimin e mësipërm.

VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR

16. Kolegji vlerëson se padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re - LRE plotëson kriteret formale të shqyrtimit të saj.

16.1. Subjekti zgjedhor Lëvizja e Re - LRE legjitimohet për të kundërshtuar vendimin nr.72, datë 12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimin nr.08, datë 15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr.3 të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re - LRE për “Shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor Lëvizja e Re, për regjistrimin e kandidatit Jonid Robet Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Neni 145 i Kodit Zgjedhor, i jep të drejtë subjekteve zgjedhore të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Në rastin konkret, nëpërmjet vendimmarrjes së tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të mos regjistrojë kandidatin për kryetar në Bashkinë Durrës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se pala paditëse ka interes të ligjshëm për të kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e pretendimeve të saj.

16.2. Kolegji konstaton se pretendimet e palës paditëse i janë nënshtruar rrugës së shqyrtimit administrativ nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

Në rastin konkret, pala paditëse kundërshton vendimin nr.72, datë 12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimin nr.08, datë 15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me pretendimin se: 1) deklarata e datës 02.02.2022 e firmosur nga një nga këshilltarët e Këshillit Bashkiak Durrës plotëson kriteret e parashikuara nga neni 68 i Kodit Zgjedhor dhe 2) Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve nuk mund ti përcaktonte palës paditëse një afat të ri prej 24 orësh për plotësim të dokumentacionit, sepse ky afat ishte i pamjaftueshëm për arsye se pala paditëse, në zbatim të nenit 27 pika 3 dhe 4 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, me kalimin e afatit të përcaktuar nga Vendimi nr. 02 të datës 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, kishte shkatërruar të dhënat në lidhje me sigurimin e numrit të nevojshëm të mbështetësve. Meqënëse ky afat, për plotësimin e dokumentacionit, nuk i ishte lënë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, KAS duhet të vendoste për regjistrimin e kandidatit në zgjedhje dhe të mos linte një afat të ri për plotësimin e dokumentacionit.

Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet e palës paditëse kanë të bëjnë me vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas vendimit nr.72, datë 12.02.2022 dhe të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve sipas vendimit nr.08, datë 15.02.2022.

Pretendimet e palës paditëse nuk shtrihen në lidhje me vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas vendimit nr.79, datë 16.02.2022 (në zbatim të vendimit nr.08, datë 15.02.2022 të KAS), sepse pala paditëse pretendon se vendimi i Komisionerit nr.72, datë 12.02.2022 dhe vendimi i KAS nr.08, datë 15.02.2022, janë të pabazuara në ligj dhe kandidati i këtij subjekti duhet të ishte regjistruar, në përfundim të procedurës administrative nga KAS.

16.3. Kolegji konstaton se kërkesëpadia është paraqitur brenda afatit ligjor pesë ditor të parashikuar nga neni 145, në lidhje me nenin 152.2 të Kodit Zgjedhor.

17. Kolegji vlerëson se subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re” nuk ka plotësuar kërkesat e parashikuara në nenin 68 pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor për regjistrimin e kandidatit Jonid Robet Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, për Bashkinë Durrës.

17.1. Kolegji vlerëson se mbështetja e anëtares së këshillit bashkiak Durrës, zj. Alneida Rroshi për kandidatin e subjektit zgjedhor LRE, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, për Bashkinë Durrës, nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 68 të Kodit Zgjedhor për regjistrimin e kandidatit në këto zgjedhje.

Konform nenit 68 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se: *“2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. 3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës.”*

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në mënyrë që një kandidat i paraqitur nga një parti politike, të regjistrohet në zgjedhjet për organet e njësisë së qeverisjes vendore duhet që partia politike të zotëroje një mandate në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore ose duhet të mbështetet nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie. Për të provuar zotërimin e mandatit, partia politike paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës.

Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e mbajtur nga pala e paditur se vetëdeklarimi i përmendur në nenin 68 pika 3 e Kodit Zgjedhor është një deklaratë përkatësie politike, e cila nënkupton një marrëdhënie zyrtare, publike dhe të qendrueshme midis mandatmbajtësit dhe subjektit politik, të cilit i përket ai. Kjo marrëdhënie përkatësie nuk vendoset me qëllimin për të shmangur kushtin e nënshkrimeve mbështetëse të zgjedhësve në momentin e regjistrimit të kandidatëve. Ajo është marrëdhënie përkatësie që ekziston përtej dhe pavarësisht procesit zgjedhor. Për këtë arsye, ajo ka forcën që të zëvendësojë listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve si kusht për regjistrimin e kandidatëve. Deklarimi i përkatësisë nga ana e mandatmbajtësit bëhet përpara institucionit dhe jo përpara administratës zgjedhore sepse marrëdhënia e tij e përkatësisë vlen jo vetëm për zgjedhjet, por vlen për çdo marrëdhënie juridike që bazohen në kriterin/kushtin e përkatësisë. Deklarimi i përkatësisë është akt që lidh mandatmbajtësin me subjektin politik dhe jo akt që lidh mandatmbajtësin me kandidatin. Kodi Zgjedhor kërkon me pikën 3, të nenit 68

shpalljen e përkatësisë ndaj subjektit dhe jo, sikurse pretendon pala paditëse, shpalljen e mbështetjes për kandidatin.

Duke iu referuar rastit konkret, pala paditëse ka siguruar për kandidatin e saj për bashkinë Durrës mbështetjen e anëtares së këshillit bashkiak Durrës, zj. Alneida Rroshi, e cila ka nënshkruar një deklaratë mbështetëse dhe ka bashkëlidhur një vërtetim (shkresa nr.1043 prot., datë 02.02.2022) të lëshuar nga Kryetari i këshillit bashkiak Durrës, me të cilin konfirmohet se zj. Alneida Rroshi është anëtare e këshillit bashkiak. Sipas shkreses nr.1372/1 prot., datë 11.02.2022 të këshillit bashkiak Durrës, të marrë mbi bazën e kërkesës së Komisionerit, rezulton se zj. Alneida Rroshi është anëtare e Këshillit Bashkiak Durrës, nga subjekti “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Në këto kushte, pavarësisht se deklaroi mbështetjen për kandidatin e LRE, anëtarja e Këshillit Bashkiak Durrës nuk është vetë në marrëdhënie përkatësie me LRE. Mandati i saj përfaqësues nuk i përket LRE, por i përket PSSH, për pasojë ai nuk mund të zëvendësojë ligjërisht nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve për llogari të LRE, por vetëm për llogari të PSSH.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se mbështetja e anëtares së këshillit bashkiak Durrës, zj. Alneida Rroshi për kandidatin e subjektit zgjedhor LRE, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, për Bashkinë Durrës, nuk plotëson kërkesat e parashikuara në nenin 68 të Kodit Zgjedhor për regjistrimin e kandidatit në këto zgjedhje.

17.2. Kolegji vlerëson se KAS nuk mund të dispononte për regjistrimin e kandidatit pa përmbushur, të paktën, njërin nga kushtet e parashikuara në nenin 68 pag.2 të Kodit Zgjedhor. Në këto rrethana, me të drejtë, në zbatim të pikës 10 të Vendimit nr.2 dt.22.01.2022 të Komisionit Rregullator, KAS i ka dhënë palës paditëse një afat të ri prej 24 orësh për plotësim të dokumentacionit.

Kolegji vlerëson se Kodi Zgjedhor përcakton kushte për regjistrimin e kandidatit, të cilat duhet të plotësohen domosdoshmërisht, pa plotësimin e të cilave kandidatët nuk mund të regjistrohen. Kodi Zgjedhor përcakton edhe dokumentacionin që duhet paraqitur për të provuar përmbushjen e kushteve. Pika 3, e nenit 68, të Kodit Zgjedhor vendos kushte forme dhe përmbajtjeje, me qëllim që vërtetimi për zotërimin e mandatit të jetë i vlefshëm dhe i pranueshëm. Me qëllim verifikimin e plotësimit të kriterëve dhe të plotësimit të të metave që mund të konstatohen në dokumentacion, në pikën 10 të Vendimit nr.2 dt.22.01.2022 të Komisionit Rregullator, përcaktohet se: *“KQZ/ KZAZ bën verifikimin e tyre jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja dhe në rast se vëren parregullsi, i kthen për plotësim. Dokumentet e plotësuara duhet të riparaqiten jo më vonë se 24 orë (njëzet e katër). KQZ-ja/ KZAZ-ja merr vendim jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga riparaqitja e tyre.”*

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, KAS nuk mund të dispononte për regjistrimin e kandidatit të LRE për kryetar Bashkie në Bashkinë e Durrësit, sa kohë nuk provohet se plotësohet, të paktën, njëri nga kushtet e parashikuara në nenin 68 pag.2 të Kodit Zgjedhor. Fakti që Komisioneri nuk i ka lënë palës paditëse një afat për plotësimin e dokumentacionit nuk mund të konsiderohet si një element që tregon se pala paditëse plotëson kushtet për regjistrim. Në çdo rast, subjekti zgjedhor duhet të plotësojë kushtet e parashikuara dhe duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që provon plotësimin e kushteve. Vlerësimi se dokumentacioni është i paplotë, pasjell mundësinë për ta plotësuar atë, brenda një afati prej 24 orësh. Fakti që Komisioneri nuk i ka dhënë palës paditëse

një afat për plotësimin e dokumentacionit nuk sjell detyrimin e KAS për të rregjistruar kandidatin, pavarësisht faktit nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 68 pag.2 të Kodit Zgjedhor.

Fakti që pala paditëse mund të ketë shkatërruar dokumentacionin për 1% të firmave mbështetëse të zgjedhësve të Bashkisë Durrës dhe koha prej 24 orësh për plotësim të dokumentacionit është e pamjaftueshme për të rimbledhur edhe një herë firmat mbështetëse, nuk është një element që mund të ndikojë në qëndrimin se për rregjistrimin e kandidatit duhet të plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 68 pag.2 të Kodit Zgjedhor. Afati prej 24 orësh është përcaktuar në pikën 10 të Vendimit nr.2 dt.22.01.2022 të Komisionit Rregullator. Në rastin konkret, në zbatim të pikës 10 të Vendimit nr.2 dt.22.01.2022 të Komisionit Rregullator, KAS i ka dhënë palës paditëse një afat të ri prej 24 orësh për plotësim të dokumentacionit dhe megjithë dhënien e këtij afati për plotësimin e dokumentacionit, pala paditëse nuk e ka plotësuar atë. Në këto rrethana, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.79, datë 16.02.2022, ka vendosur mosrregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

17.3. Kolegji e gjen të pambështetur pretendimin e palës paditëse se vendimet e Komisionerit dhe të KAS duhet të shfuqizohen dhe kandidati për kryetar bashkie i propozuar prej saj për kryetar Bashkie në Bashkinë e Durrësit duhet rregjistruar sepse KQZ po përdor standard të dyfishtë në regjistrimin e kandidatëve të subjektit Zgjedhor “Lëvizja e Re”. Në vendimin nr.50 të datës 10.02.2022 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim kërkesën për regjistrim të kandidatit të Lëvizjes së Re për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Dibër, z. Dritan Hajri Torba duke urdhëruar KZAZ nr.19 Dibër të bëjë rregjistrimin e kandidatit të LRE për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, duke qënë në të njëjtat kushtë me kandidatin për kryetar Bashkie në Bashkinë Durrës.

Kolegji vlerëson se shqyrtimin e pretendimeve të palës paditëse në lidhje me ligjëshmërinë e vendimmarrjes së palës së paditur objekt gjykimi, e realizon në përputhje me Kushtetutën dhe me Kodin Zgjedhor dhe jo në përputhje me vendimmarrjen e mepareshme të Komisionerit apo të KZAZ nr.19, Dibër. Kolegji bën një vlerësim të tij në lidhje me situatën ligjore dhe faktike, në përputhje me Kushtetutën dhe me Kodin Zgjedhor dhe nuk është i lidhur me qëndrime të mbajtur nga organe të tjera për çështje të ngjashme.

18. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji konkludon se padia e paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, është e pambështetur në prova dhe në ligj dhe për pasojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158, pika 3 të Kodit Zgjedhor

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesë – padisë.

- Shpenzimet gjyqësore I ngarkohen palës paditëse.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.02.2022.

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Blerona HASA
(mendim paralel)

GJYQTAR
Gentian MEDJA

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTARE
Esmeralda XHILI